



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:220581

Datë: 10.01.2024

Numri i dokumentit: 05456547

P.nr. 270/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, në çështjen penale kundër të pandehurit A.Hpër shkak te veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajjtshme nga neni 320 par. 1 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.555/2021 e datës 30.09.2021, në bazë të nenit 248 par.1 nën par. 1.4 të Kodit nr.08/L-032 të Procedurës Penale (tutje KPP), dhe neneve 14, 15, 17 te Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seancë me datë **10.01.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit me numër të lëndës në ndërmjetësim **ND.nr.459/23 e datës 31.10.2023**, në mes të pandehurit A.H në njërën anë dhe përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit J.P av.Gani Kelmendi, në anën tjetër.
- II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.555/2021 e datës 30.09.2021, dhe **PUSHOHET** procedura penale, kundër të pandehurit **A.H** i lindur me datë ... në I., me vendbanim ne fshatin D. rr. "Bekë Salih" Komuna I., me nr. personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i akuzuar për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajjtshme nga neni 320 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.
 - **Për shkak te arritjes se marrëveshjes në procedurën e ndërmjetësimit sipas Ligjit për Ndërmjetësim, e cila marrëveshje është pranuar zyrtarisht nga gjykata.**
- III. Marrëveshja e arritur** në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve si në pikën I, te këtij dispozitivi, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
- IV. Shpenzimet e procedurës penale** bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.555/2021 e datës 30.09.2021, kundër të pandehurve A.M, I.L dhe A. H për shkak se secili veç e veç kanë kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata, këtë çështje penale sa i përket të pandehurit A.H për veprën penale e cila i vihet në barrë, e ka veçuar nga çështja penale e cila është proceduar në këtë gjykatë P.nr.292/21.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 31.10.2023, ne te cilën seancë përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka propozuar që kjo çështje penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit qe te tentoj qe me të pandehurin të arrijnë marrëveshje.

Gjykata pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, ka marrë mendimin e palëve prezentë në seancë, e duke u bazuar në dispozitat e nenit 2, 4, 8 dhe 12 të Ligjit për Ndërmjetësim dhe nenin 229 par.1 dhe 2 të KPP-së, **me vendimin e datës 31.10.2023**, e ka referuar këtë çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog.

Gjykata **me datë 31.10.2023**, nga Qendra e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog, është njoftuar me:

- **Modelin e Marrëveshjes për Ndërmjetësim** (Shtojcën 2), sipas të cilës rezulton se palët e lartcekura si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, janë pajtuar për ta zgjidhur kontestin e tyre në procedurën e ndërmjetësimit, dhe
- **Modelin e Marrëveshjes për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar** (Shtojcën 3), sipas të cilës rezulton se ndërmjet palëve të lartcekura si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi është arritur marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit. E cila marrëveshje pasi që është nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi, është proceduar në gjykatë te gjyqtari i çështjes për aprovim.

Gjykata **me vendimin e datës 06.11.2023** (shtojcën 5), e ka aprovuar marrëveshjen e arritur ne procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, konform nenit 15 te Ligjit për Ndërmjetësim.

Sipas nenit 248 par. 1, nën par. 1.4 të KPP-së, përcaktohet se Gjykata e hedhë aktakuzën dhe e pushon procedurën kur: “ *i pandehuri dhe i dëmtuari kanë lidhur marrëveshje ndërmjetësimi që është pranuar zyrtarisht nga gjykata*”.

Gjykata pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, duke vlerësuar se marrëveshja e lidhur ne procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve është e paraparë dhe ne pajtim me Ligjin për Ndërmjetësim dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, si dhe pas aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës, e duke

vepruar konform nenit të sipërcituar 248 par. 1, nën par. 1.4 të KPP-së, u vendos që të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale ndaj të pandehurit si në pikën II, të diapozitivit të këtij aktvendimi.

Konstatimi në pikën III, të dispozitivit të këtij aktvendimi, se marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve në këtë çështje penale, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi, bazohet në nenin 229 par.6 të KPP-së.

Gjykata vendimin në pikën IV, të dispozitivit të këtij aktvendimi, lidhur me shpenzimet e kësaj procedure penale e ka marrë konform nenit 453 par.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të neni 248 par.1 nën par. 1.4 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

Gjyqtari,
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej tri (3) ditësh, nga dita e pranimit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. *Në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.*